N.H. V.P. „IBËR-LEPENC" SH.A. D.D.
01- 1590 Dt. 20-05-2025
PRISHTINË-PRIŠTINA

NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE **"IBËR - LEPENC"** SH.A.

HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE **"IBËR - LEPENC"** J.S.C.

VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE **"IBËR - LEPENC"** D.D.

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERMENT
MINISTRIA E EKONOMISË
MINISTARSTVO EKONOMIJE
MINISTRY OF ECONOMY
Njesia Org / Org. Jedin / Org Unit: 01/3
Nr. Prot / Br. Prot / Prot. No: 2225
Nr. i faqeve / Broj stranica / No. pages: –
Data / Datum / Date: 21.05.25
PRISHTINË/A NO.1

# Raporti tre mujor, Janar-Mars 2025 TM1

Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e tretë (3) të rregullt të mbajtur me datë 20.05.2025 pas shqyrtimit të Raportit TM1-2025 mbi zhvillimet e aktiviteteve afariste në NPH "Ibër Lepenc" Sh.A, mori vendim për miratimin e këtij raporti dhe kërkoi që i njëjti të përcillet në NJPMNP.

| | Delegoi | Aprovoi |
|---|---|---|
| Emri Mbiemri | Kryeshefi Ekzekutiv: | Kryesuesi i BD: |
| Nënshkrimi | **Faruk MUJKA** | **Bajram MUSTAFA** |
| Data: 20.05.2025 | | |

Ndërmarrja Hidroekonomike "IBËR-LEPENC" sh.a. Vodoprivredno preduzeće d.d. Prishtinë-Priština

NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE **"IBËR - LEPENC"** SH.A.

HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE **"IBËR - LEPENC"** J.S.C.

VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE **"IBËR - LEPENC"** D.D.

Sheshi "Bill Klinton" Nr.13 - Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@iber-lepenc.org

| | |
|---|---|
| ***Për*** : | **Bordin e Drejtorëve** |
| ***Nga***: | **Faruk Mujka - Kryeshef Ekzekutiv – N.H "Iber-Lepenc" Sh.A** |
| ***Lënda:*** | **Raport tremujor i punës: Janar-Shkurt-Mars 2025** |
| ***Data:*** | **25.04.2025** |

# *Efikasiteti i përgjithshëm tremujor Janar-Shkurt-Mars 2025*



Gjatë tremujorit të parë për vitin 2025(TM1) kemi pas mjaft angazhime dhe sfida që i kemi kryer me përkushtim, duke arritur suksese të dukshme . Por kjo nuk do të thot që ne duhet të ngadalësojmë hapin në rrugëtimin tonë . Prandaj këtë vit do të vazhdojmë punën me një përkushtim edhe më të madh, drejt realizimit të qëllimeve bazuar në Planin e biznesit .

Nga zyra e shitjes kam pranuar këtë pasqyrë të punës , paraqitur në tabelat si në vijim :

**Shitja e energjisë elektrike për muajin Janar 2025**

| Muaji | Çmimi € | Sasia MWh | Vlera € |
|---|---|---|---|
| Dhjetor | € 174.74 | 3,952.56 | € 690,662.87 |

**Shitja e energjisë elektrike për muajin Shkurt 2025**

| Muaji | Çmimi € | Sasia MWh | Vlera € |
|---|---|---|---|
| Shkurt | € 202.03 | 3,573.30 | € 721,926.09 |

**Shitja e energjisë elektrike për muajin Mars**

| Muaji | Çmimi € | Sasia MWh | Vlera € |
|---|---|---|---|
| Mars | € 147.78 | 3,258.37 | € 481,520.90 |

# Aktivitetet e Departamenteve

## ***Departamenti „Uji dhe Gjenerimi"***

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2025 (Janar-Mars), Departamenti "Uji dhe Gjenerimi" ka realizuar aktivitete të rëndësishme për mirëmbajtjen e sistemit të kanaleve për furnizim me ujë dhe përgatitjen për sezonin e ardhshëm të ujitjes. Janë distribuar gjithsej 14,562,280 m³ ujë tek konsumatorët kryesorë, ndërsa nga HC Ujëmani janë gjeneruar 11,724.75 MWh energji elektrike, që paraqet 44% më pak se Plani i biznesit prej 21,000 MWh për këtë periudhë. Niveli i akumulimit Ujëman ka shënuar rritje nga 678.46m (243 mil. m³) në fillim të Janarit në 684.61m (295 mil. m³) në fund të Marsit, si rezultat i prurjeve mesatare prej 13.3 m³/sec.

**Aktivitetet kryesore**

**1.1 Mirëmbajtja e Infrastrukturës**

- **Kanali kryesor:** Janë kryer punët e mirëmbajtjes për sigurimin e rrjedhës së ujit dhe furnizimin e konsumatorëve;
- **Kanalet sekondare:** Ka filluar pastrimi për përgatitjen e sezonës së ujitjes;
- **Diga e Ujëmanit:**
  - Funksionalizimi i zyrave (kontinjerëve) për shërbimin e mirëmbajtjes;
  - Pastrimi i vegjetacionit në trupin e digës;
  - Largimi i prurjeve të mëdha inerte në liqe.

### 1.2 Burimet Njerëzore

- Është kompletuar rekrutimi i punëtorëve dhe formimi i ekipeve punuese në NJP Ujmani

## 2. Distrubuimi I ujit

Gjatë tremujorit Janar-Mars 2025 janë distribuuar gjithsej **14,562,280 m³** ujë tek konsumatorët kryesorë sipas këtij shpërndarjeje:

| TMI | $m^3$ |
|---|---|
| **KRU Mitrovicë** | **4,835,579** |
| **KRU Mitrovicë ( Vushtrri)** | **1,817,955** |
| **KUR Prishtina(Shkabaj)** | **4,006,800** |
| **KUR Prishtina(Drenas)** | **791,968** |
| **NewCo Ferronikel CoL.L.C** | **388,379** |
| **KOSOVA B** | **2,721,600** |
| **TOTALI** | **14,562,280** |

Paraqitja grafike e sasive te distribuara të ujit në $m^3$ Janar-Mars 2025






| | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|---|---|---|---|---|
| **KRU Mitrovicë** | **5,443,200** | **5,310,357** | **4,751,622** | **4,835,579** | **4,835,579** |
| **KRU Mitrovicë ( Vushtrri)** | **1,476,046** | **1,649,265** | **1,696,841** | **1,817,955** | **1,817,955** |
| **KUR Prishtina(Shkabaj)** | **3,467,044** | **4,261,384** | **2,935,360** | **4,006,800** | **4,006,800** |
| **KUR Prishtina(Drenas)** | **722,350** | **928,890** | **726,899** | **791,968** | **791,968** |
| **NewCo Ferronikel CoL.L.C** | **550,313** | **243,566** | **259,760** | **388,379** | **388,379** |
| **KOSOVA B** | **2,721,600** | **2,543,400** | **2,721,600** | **2,721,600** | **2,721,600** |


Trend i Distribuimit të Ujit sipas Konsumatorëve (2021-2025)
KRU Mitrovica
KRU Mitrovica (Vushtrri)
KUR Prishtina (Shkabaj)
KUR Prishtina (Drenas)
NewCo Ferronikel
KOSOVAB
6M
3M
2M
1M
0
Sasia e ujit të distribuuar (m³)
2021
2022
2023
2024
2025
Viti


Sasite e distribuara të ujit për gjatë viteve 2021-2025 për TM1
6,000,000
5,000,000
4,000,000
3,000,000
2,000,000
1,000,000
0
KRU Mitrovice
KRU Mitrovice ( Vushtrri)
KUR Prishtina(Shkabaj)
KUR Prishtina(Drenas)
NewCo Ferronikel CoL.L.C
KOSOVA B
2021
2022
2023
2024
2025

# 3. GJENERIMI I ENERGJISË

Gjatë tremujorit Janar-Mars 2025, nga HC Ujëman janë gjeneruar gjithsej **11,724.75 MWh** energji elektrike, prej të cilave **11,562.36 MWh** janë injektuar në sistemin transmetues. Kjo paraqet **44% më pak** se sa ishte planifikuar për këtë periudhë (21,000 MWh), kryesisht për shkak të prurjeve në liqe dhe harmonizimit të kërkesave të ALPEX.

## 3.1 Shpërndarja e Gjenerimit Sipas Muajve (vlerësim)

- **Janar:** ~4,000 MWh
- **Shkurt:** ~4,600 MWh
- **Mars:** ~4,124.75 MWh

*Krahasimi i gjenerimit me periudhën e njejtë për vitet 2016-2025*






Niveli i ujit në akumulim me 1 janar ka qenë në kuotën 678.46m (243 mil. $m^3$ ,shkalla 91) ndërsa me 31 mars nivel ka qenë në kuotën 684.61 m (295 mil. $m^3$ ,shkalla 57)




Niveli i Akumulimit në pendën "Ujëman" gjatë periudhës kohore TM1 ndër vitet 2016-2025
695
690
685
680
675
670
1/1/20XX
1/3/20XX
1/5/20XX
1/7/20XX
1/9/20XX
1/11/20XX
1/13/20XX
1/15/20XX
1/17/20XX
1/19/20XX
1/21/20XX
1/23/20XX
1/25/20XX
1/27/20XX
1/29/20XX
1/31/20XX
2/2/20XX
2/4/20XX
2/6/20XX
2/8/20XX
2/10/20XX
2/12/20XX
2/14/20XX
2/16/20XX
2/18/20XX
2/20/20XX
2/22/20XX
2/24/20XX
2/26/20XX
2/28/20XX
3/2/20XX
3/4/20XX
3/6/20XX
3/8/20XX
3/10/20XX
3/12/20XX
3/14/20XX
3/16/20XX
3/18/20XX
3/20/20XX
3/22/20XX
3/24/20XX
3/26/20XX
3/28/20XX
3/30/20XX
2016
2017
2018
2019
2020
2021
2022
2023
2024
2025




Prurjet mesatare në akumulimin Ujëman gjatë tremujorit TM1 ishin **13.3** $m^3$/sec

| | **Vëllimi $10^6 m^3$** | **Prurjet $m^3$/sec** |
|---|---:|---:|
| Janar | **267** | **12.20** |
| Shkurt | **275** | **9.40** |
| Mars | **295** | **13.90** |
| | | |
| | | |



| | | | | Prurjet gjate viteve $m^3/sec$ | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2025 | 2024 | 2023 | 2022 | 2021 | 2020 | 2019 | 2018 | 2017 | 2016 |
| *Janar* | *16.6* | *12.2* | *32.1* | *8.4* | 23.88 | 5.3 | 5.6 | 8 | 4.5 | 7.1 |
| *Shkurt* | *9.4* | *9.4* | *18.5* | *12.7* | 39.19 | 10.9 | 20.03 | 21.1 | 18.2 | 16.9 |
| *Mars* | *13.9* | *12.5* | *23.1* | *13.3* | 20.92 | 21.8 | 22.14 | 36.3 | 25.2 | 31.8 |



# ***Departamenti "Ujitja"***

Departamenti"Ujitja" gjatë periudhës Janar-Mars (TM1) 2025, së bashku më tri Njësitë Punuese:Vushtrri, Shkabaj dhe Komoran, ka vazhduar me aktivitetet e punës që dalin konform detyrave të punës gjatë tre mujorit të parë të vitit. Gjatë TM1 ka përfshirë këto veprime si në vijim: kontrollimin e infrastrukturës së ujitjes, mirëmbajtjen e Stacioneve Pompike, mirëmbajtjen makinerike dhe elektrike, përgatitjen e sistemit të ujitjes për fillimin e sezonit të ri të ujitjes, regjistrimin e aseteve të ndërmarrjes, etj.

**Kontrolli i infrastrukturës së ujitjes**

Punëtorët në terren kanë vazhduar me vëzhgimin rutinor të infrastrukturës së ujitjes, për të siguruar që sistemi të jetë i mbrojtur. Këto kontrolle kanë përfshirë inspektimin e pjesëve fazonerike, pusetat, hidrantat dhe përcjelljen nëse afër apo mbi gypa të ujitjes po ndërtohen ndërtime të ndryshme.

**Mirëmbajtja e stacioneve pompike**

Punonjësit e Departamentit "Ujitja" në tri Njësitë Punuese kanë vazhduar me mirëmbajtjen e rregullt të pjesës se makinerike dhe elektrike në të gjitha stacionet pompike. Kontrolli rutinor i prezencës së punëtorëve nëpër Stacione Pompike është bërë për të siguruar që punonjësit janë në vendin e tyre të punës dhe se po kryejnë detyrat e tyre me efikasitet dhe saktësi.

Në muajin Janar 2025, më vendim të Kryeshefit në të tri Njësitë Punuese janë formuar komisionet për regjistrimin e aseteve të ndërmarrjes , ku në koordinim me Zyrën e Financave gjatë muajit Janar 2025, kanë përfunduar regjistrimin e aseteve në të tri Njësitë punuese.

Gjatë muajit *shkurt* aktivitetet në terren kanë qenë më të vogla, udhëheqësit e Njësive punuese së bashku më punëtorët e terrenit kanë bërë monitorimin e sistemit të ujitjes dhe janë vizituar punëtorët nëpër stacionet pompike. Një pjesë e puntorëve janë ende duke i shfrytëzuar pushimet e rregullta vjetore dhe ditët e lira, që i kanë nga puna më orarë të zgjatur gjatë sezonit të ujitjes.

Me kërkesën e Departamentit Uji&Gjenerimi e kemi dërguar Ekskavatorin në Kushtovë për kryerjen e disa punëve të parapara nga ky Departament. Sipas vendimit janë hartuar specifikat për realizimin e dy tënderve: "Furnizimi më Lidhëse Riparuese" dhe "Furnizim më Gypa dhe Fazoneri".

Në kuadër të këtijë muaji janë shpërndarë edhe Pyetsorët për Kënaqshmërin e Konsumatorve (Fermerve).

Përveç punëve tjera kanë punuar në tubacionin J – Tranzit, Ø 600 B, është bërë largimi i dheut nga gypi, pastruar puseta dhe është larguar uji, në mënyrë që inxhinjeri të ketë mundësi për matjen e gypave dhe fazonerisë së nevojshme për rehabilitimin e kësaj pjese të gypit J-tranzit.

Në Njësinë Punuese në Komoran është punuar edhe ne inkasimin e borxheve për vitin 2024.

Që në fillim të muajit Mars 2025, me përmirësimin e kushteve meteorologjike, punëtorët e tri Njësive punuese kanë vazhduar me vëzhgimin e rrjetit të ujites, dhe është bërë identifikimi i prishjeve në rrjetin e ujitjes, si dhe kanë caktuar prioritetët për fillimin e përgatitjës së sistemit për sezonin e ri të ujitjes.

Plani i veprimit për përgatitjen e sistemit të ujitjes për fillimin e sezonit të ri të ujitjes është i bazuar edhe në kërkesat e fermerëve, pra në pjesë të hidrosistemit ku fermerët shprehin interesim për ujitjen e tokave bujqësore, ne, do të veprojmë me prioritet.

Në të tri Njësit Punuese punët kanë filluar në pastrimin e kanaleve të hapura është bërë prerja e shkurreve përgjatë dy anëve të kanalit, pastrimi i pusetave, përpunimi dhe vajosja e fazonerisë.

Në të tri Njësitë punuese është punuar edhe në rehabilitimin e gypave të dëmtuar, siç janë: gypi J-tranzit Ø 600, *PE-100,* në Nj.P. Shkabaj, pra është punuar paramasë-parallogaria, dhe është bërë kërkesa për fillimin e procedurave të prokurimit. Poashtu në Nj.P. në vushtrri është punuar Pramasë-parallogaria pë ndrrimin e gypit të çelikut Ø 300, në shtratin e Lumit Ibër në fshatin Vinarc. Për ndrrimin e gypit të elikut është punuar paramase-parallogaria, dhe eshtë bërë kërkesa për fillimin e procedurave. Të dy këto projekte do të realizohen më Operator Ekonomik për arsye se në nuk kami mundësi për rehabilitimin e tyre. Njësia Punuese në Komoran, në kuadër të punës për rehabilitimin e rrjetit të ujitjes ka vazhduar punën në fshatin Nekoc, komuna Drenas ku ka larguar valvulat me profil Ø 250, dhe tubat L.P.4 Ø 600 AC dhe L.P.4 Ø 500 AC, të cili janë të dëmtuar , janë vendosur valvola dhe gypat e ri, krejt kjo me qëllim që sistemi i ujitjes të funksionalizohet dhe ti mundësohet fermerëve të shfrytëzojnë ujin për ujitjen e kulturave bujqësore, duke rritur rendimentin dhe cilësinë e prodhimeve bujqësore. Janë organizuar takime me Drejtorët e Drejtorive Komunale për Bujqësi, të komunave: Vushtrri, Obiliq, Drenas, Prishtinë dhe Mitrovicë, e të cilëve edhe më E-mail u kemi kërkuar bashkëpunim për nënshkrimin e Memorandumeve të Bashkëpunumit, në mënyrë që komunat dhe Drejtoratet e Bujqësisë të subvencionojnë fermerët për ujitjen e tokave bujqësore për vitin 2025. Bazuar në diskutimet me Drejtorët, besojmë që Memorandumet do të nënshkruhen me të gjitha komunat e lartë cekura.

*Me anë të fotove po e pasqyrojmë punën që është bërë gjatë muajit Janar- Mars 2025, në Nj.P., Vushtrri, Shkabaj dhe Komoran.*





*Gypi i dëmtuar i Çelikut* Ø 300, në Lumin Ibër, fshati Vinarc.



*Matjet e gypit J-tranzit Ø 600, PE-100.*



*Sanimi i gypit AC, më Shellne Riparuese.*

## ***Shërbimi i Financave***

Sa u përket të hyrave gjatë tremujorit të parë të vitit 2025 të hyrat e Ndërmarrjes janë realizuar në vlerë **2,556,667** €, ndërsa ishin planifikuar të realizohen në vlerë prej **2,748,400.00€** që do të thotë që të hyrat e realizuara janë për **7%** më të ulëta se të planifikuara ndërsa për **9%** më të larta se në periudhën e njejtë të vitit paraprak.

- Nga energjia elektrike janë realizuar të hyrat në vlerë prej **1,983,689€**, ndërsa kanë qenë të planifikuara të realizohen të hyrat në vlerë **2,205,000€** apo shprehur në përqindje realizimi ishte më i ultë për **10%** se planifikimi e për **12 %** më i lartë se realizimi në vitin papraprak.
- Nga shitja e ujit të papërpunuar janë realizuar të hyrat në vlerë prej **556,518** €, ndërsa të planifikuara ishin **543,400€**. Realizimi ishte për **2%** më i lartë se planifikimi dhe për **2 %** më i ultë në krahasim me periudhën e njejtë të vitit paraprak.
- Të hyrat tjera në vlerë **16,460.13€** janë kryesisht të ardhura nga interesi bankar.
- Në vijim janë paraqitur në formë tabelare të hyrat sipas llojit, sasisë dhe vlerës monetare:

**Tabela nr. 1 RAPORTI I BIZNESIT PËR PERIUDHËN TM1 2025**

| Nr. | Emërtimi | Njësia matëse | Realizimi TM1 2024 | Plani TM1 2025 | Realizimi TM1 2025 | % e realizimit në raport me planin | % e realizimit në raport me 2023 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 0 | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 (5:4) | 7 (5:3) |
| 1 | **PRODHIMI** | | | | | | |
| 1.1 | Energjia elektrike | Mwh | 18,301.84 | 21,000.00 | 11,646.75 | 55 | 64 |
| 1.2 | Uji | m³ | 14,865,067.00 | 14,024,570.00 | 14,642,480.00 | 104 | 99 |
| 1.3 | Ujitja | ha | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| 2 | **TË HYRAT** | | **2,341,134.26** | **2,748,400.00** | **2,556,666.95** | **93** | **109** |
| 2.1 | Energjia elektrike | € | 1,774,114.37 | 2,205,000.00 | 1,983,688.61 | 90 | 112 |
| 2.2 | Uji | € | 567,013.23 | 543,400.00 | 556,518.21 | 102 | 98 |
| 2.3 | Ujitja | € | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| 2.4 | Të tjera | € | 6.66 | 0.00 | 16,460.13 | 247,149 | 247,149 |

**Shpenzimet**

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2025 shpenzimet e ndërmarrjes kanë arritur vlerën prej **1,198,466€**, ndërsa ishin planifikuar të shpenzohen **1,497,668** €.Realizimi i shpenzimeve është më i ulët për **20%** në krahasim me planifikim dhe për **5 %** më i ulët se periudha e njëjtë e vitit të kaluar. Shpenzimet kryesore të Ndërmarrjes gjatë këtij 3 mujori janë në paga dhe meditje ku vlera e tyre arrin në **905,946** €,

ndërsa pjesa tjetër e shpenzimeve janë kryesisht taksat e ndryshme për rregullatorë, shpenzimet komunale, shpenzimet e karburanteve dhe shpenzimet e mirëmbajtjes.

Në vijim janë paraqitur në formë analitike të gjitha shpenzimet e ndodhura gjatë periudhës janar-mars 2025:

**Tabela nr. 2. Raporti analitik i shpenzimeve**

| Kodi | Kategoria e shpenzimeve | Realizimi TM1 2024 | Plani 2025 | Realizimi TM1 2025 | Indeksi % | Indeksi % |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1 | 2 | 3 | 4=(2:1) | 5=(2:3) |
| **B.1** | **Pagat dhe meditjet** | **1,036,732.14** | **1,073,162.53** | **905,946.25** | 84 | 87 |
| B.1.1 | Pagat neto të punëtorëve | 509,085.60 | 787,268.26 | 648,953.50 | 82 | 127 |
| B.1.2 | Pagat ndrrimit nates | 13,467.89 | 13,200.00 | 18,959.23 | 0 | 0 |
| B.1.3 | Pagat tjera - 24 paga-Bonuset | 272,436.07 | 0.00 | 2,200.00 | 0 | 1 |
| B.1.4 | Paga percjellse | 0.00 | 2,868.53 | 2,897.00 | 101 | #DIV/0! |
| B.1.5 | Shujta | 53,812.00 | 71,454.00 | 62,968.00 | 88 | 117 |
| B.1.6 | Tatimi ne paga | 66,970.39 | 64,241.54 | 55,703.67 | 0 | 83 |
| B.1.7 | Kontributet e punemaresit 5% | 49,262.25 | 53,658.10 | 42,901.50 | 80 | 87 |
| B.1.8 | Kontributi i ndërmarrjes 5% | 49,262.25 | 53,658.10 | 42,901.50 | 80 | 87 |
| B.1.9 | Antarsia sindikale | 1,932.89 | 0.00 | 2,481.01 | 0 | 0 |
| B.1.10 | Sigurimi shëndetësor | 14,676.90 | 17,964.00 | 17,112.90 | 0 | 0 |
| B.1.11 | Pagat e Bordit | 5,825.90 | 8,850.00 | 8,867.94 | 0 | 0 |
| **B.2** | **Shpenzimet e udhëtimëve zyrtare dhe reprezentacionet** | **9,123.50** | **6,020.00** | **2,427.02** | 40 | 27 |
| B.2.1 | Shpenzimet e udhëtimëve zyrtare | 4,624.32 | 2,780.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| B.2.2 | Shpenzimet e reprezentacionit | 4,499.18 | 3,240.00 | 2,427.02 | 75 | 54 |
| **B.3** | **Shpenzimet e marketingut** | **0.00** | **900.00** | **0.00** | 0 | 0 |
| B.3.2 | Shpenzimet e marketingut | 0.00 | 900.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| **B.4** | **Shpenimet e mirëmbajtjës** | **7,195.28** | **31,351.97** | **6,342.43** | 20 | 88 |
| B.4.1 | Mirembajtja dhe servisimi i automjeteve | 1,249.84 | 4,904.97 | 4,723.07 | 96 | 378 |
| B.4.2 | Mirëmb.e objekteve dhe paisjeve | 192.37 | 2,635.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| B.4.3 | Mirëmbatja infrastrukturore | 0.00 | 300.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| B.4.4 | Mirëmbajtja tekniko-informative | 5,396.97 | 12,720.00 | 1,253.21 | 10 | 23 |
| B.4.5 | Servisimi dhe mbushja e aparatave kundër zjarrit | 356.10 | 10,792.00 | 366.15 | 3 | 103 |
| **B.5** | **Shpenzimet komunale** | **50,027.67** | **52,529.05** | **60,772.17** | 116 | 121 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| B.5.1 | Shpenzimet e ujit | 478.62 | 502.55 | 135.33 | 27 | 28 |
| B.5.2 | Shpenzimet për mbeturina | 496.32 | 521.14 | 687.39 | 132 | 138 |
| B.5.3 | Energjia Elektrike | 46,433.58 | 48,755.26 | 58,079.28 | 119 | 125 |
| B.5.4 | Shpenzimet e ngrohjes (Termokos) | 2,619.15 | 2,750.11 | 1,870.17 | 68 | 71 |
| **B.6** | **Material harxhues** | **1,169.23** | **48,615.00** | **3,649.99** | 8 | 312 |
| B.6.1 | Artikuj me vlerë të vogël | 311.62 | 20,550.00 | 3,409.69 | 17 | 1094 |
| B.6.2 | MHT-mbrojtja higjeno-teknike | 0.00 | 21,945.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| B.6.3 | Material elektrik | 15.68 | 270.00 | 187.64 | 0 | 1197 |
| B.6.4 | Material higjenik | 14.32 | 1,860.00 | 52.66 | 3 | 368 |
| B.6.5 | Material për zyre | 827.61 | 3,990.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| **B.7** | **Material për ndërrimin dhe riparimin e gypave në rrjetin e ujitjes** | **0.00** | **2,000.00** | **552.00** | 28 | |
| B.7.1 | Material për ndërrimin dhe riparimin e gypave në rrjetin e ujitjes | 0.00 | 2,000.00 | 552.00 | 28 | |
| **B.8** | **Shpenzimet për shërbime** | **2,811.00** | **25,150.00** | **2,842.99** | 11 | 101 |
| B.8.1 | Trajnime | 2,713.00 | 13,000.00 | 2,652.00 | 20 | 98 |
| B.8.2 | Shpenzime te shtypjes | 98.00 | 150.00 | 190.99 | 127 | 195 |
| B.8.3 | Shpenzime projektuese | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| B.8.4 | Rivlersimi I aseteve | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| B.8.5 | Shpen.sherbimeve ligjore | 0.00 | 12,000.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| **B.9** | **Detyrime kontigjente** | **0.00** | **0.00** | **0.00** | 0 | 0 |
| B.9.1 | Detyrime kontigjente | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| **B.10** | **Shpenzime tjera** | **7,473.65** | **49,290.00** | **54,204.08** | 110 | 725 |
| B.10.1 | Shpenzime tjera | 5,208.79 | 47,340.00 | 52,582.21 | 111 | 1009 |
| B.10.2 | Parkingu për automjete | 1,075.86 | 1,350.00 | 756.87 | 56 | 70 |
| B.10.3 | Autolarja | 332.00 | 300.00 | 325.00 | 108 | 98 |
| B.10.4 | Çregjistrimet | 332.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| B.10.5 | Konkurset | 525.00 | 300.00 | 540.00 | 0 | 0 |
| **B.11** | **Shpenzimet e telekomunikimit** | **5,178.73** | **7,428.00** | **6,173.97** | 83 | 119 |
| B.11.1 | Telefonia fikse | 116.01 | 334.50 | 120.86 | 36 | 104 |
| B.11.2 | Telefonia mobile | 1,392.26 | 1,927.50 | 1,651.24 | 86 | 119 |
| B.11.3 | Kablloviku | 179.34 | 40.50 | 243.90 | 602 | 136 |
| B.11.4 | Interneti | 3,453.42 | 5,065.50 | 4,139.25 | 82 | 120 |
| B.11.5 | Shpenzimet postare | 37.70 | 60.00 | 18.72 | 0 | 50 |
| **B.12** | **Derivatet** | **5,506.72** | **16,224.58** | **6,463.65** | 40 | 117 |
| B.12.1 | Nafta | 5,301.74 | 6,230.00 | 6,179.09 | 99 | 117 |
| B.12.2 | Benzina | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| B.12.3 | Vajrat | 204.98 | 9,994.58 | 284.56 | 3 | 139 |
| **B.13** | **Provizionet dhe taksat** | **133,263.37** | **178,696.79** | **148,153.94** | 83 | 111 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| B.15.1 | Tatimi ne pronë | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| B.15.2 | Taksa për rregullatorë | 54,999.83 | 89,822.66 | 65,478.95 | 73 | 0 |
| B.15.2.1 | Taksa për MMPH | 74,082.67 | 83,346.13 | 78,877.17 | 95 | 106 |
| B.15.3 | Provizioni bankar | 1,041.68 | 800.00 | 1,201.94 | 150 | 115 |
| B.15.4 | Sigurimi i automjeteve | 2,270.56 | 2,928.00 | 1,842.24 | 0 | 0 |
| B.15.5 | Regjistrimi i automjeteve | 868.63 | 1,800.00 | 753.64 | 42 | 87 |
| B.15.6 | Interesi i kredisë BB | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| B.15.7 | Tatimi në fitim | 0.00 | 0.00 | 0.00 | | 0 |
| **B.14** | **Kompenzimi i dëmëve** | **0.00** | **6,300.00** | **937.50** | 15 | 0 |
| B.14.1 | Kompenzimi i dëmëve | 0.00 | 6,300.00 | 937.50 | 15 | 0 |
| **B.15** | **Shpenzimet nga imbalanca** | **0.00** | **0.00** | **0.00** | 0 | 0 |
| B.15.1 | Shpenzimet nga imbalanca | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| | **Total** | **1,258,481.29** | **1,497,667.91** | **1,198,465.99** | **80** | **95** |

**Rezultati financiar**

Gjatë këtij tremujori ndërmarrja ka pasur rezultat pozitiv financiar në vlerë prej **206,997.63** €. Në vijim mund të shihet pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve.

**Tabela 3. Pasqyra e të ardhurave TM1 2025**

| **Pasqyra e të ardhurave** | **2024** | **2025** |
|---|---|---|
| **Të ardhurat** | **(€)** | **(€)** |
| Të Ardhurat nga shitja energjisë elektrike | 1,759,521.02 | 1,890,579.78 |
| Të Ardhurat nga jobalanca pozitive | 14,593.35 | 93,108.83 |
| Të Ardhurat nga shitja e ujit me shumicë | 567,013.23 | 556,518.21 |
| Te ardhurat nga ujitja | - | - |
| Të Ardhurat Tjera | 6.66 | 16,460.13 |
| **Total te Ardhurat Bruto** | **2,341,134.26** | **2,556,666.95** |
| **Shpenzimet** | | |
| Pagat dhe meditjet | 1,036,732.14 | 905,946.25 |
| Shpenzimet për udhëtime zyrtare | 4,624.32 | - |
| Reprezentacioni | 4,499.18 | 2,427.02 |
| Shpenzimet e Marketingut | - | - |
| Shpenzimet e Mirëmbatjes | 7,195.28 | 6,342.43 |
| Shpenzimet Komunale | 50,027.67 | 60,772.17 |
| Material Hargjues | 1,169.23 | 3,649.99 |
| Material për rrjetin e ujitjes | - | 552.00 |
| Shpenzime për shërbime | 2,811.00 | 2,842.99 |
| Shpenzime Tjera | - | - |
| Shpenzimet Telekomunikuese | 7,141.65 | 54,204.08 |
| Derivatet | 5,178.73 | 6,173.97 |
| Kompenesimi dhe Taksat | 5,506.72 | 6,463.65 |
| Kompensimi i Dëmeve | 133,263.37 | 148,153.94 |
| Shpenzimet nga Imbalanca | - | 937.50 |
| **Totali i Shpenzimeve** | **1,258,149.29** | **1,198,465.99** |
| | | |
| **Fitimi Operativ** | **1,082,984.97** | **1,358,200.96** |

| | | |
|---|---|---|
| **Total Zhvlerësimi** | **1,157,105.00** | **1,151,203.33** |
| | | |
| **Total Fitimi (Humbja) Neto** | **- 74,120.03** | **206,997.63** |

## *Departamenti i Shërbimeve të Përbashkëta*

Gjatë këtyre muajve *Janar-Shkurt-Mars të vitit 2025* ka nisur përgatitja për inicimin e projekteve të parapara me Planin e biznesit si dhe Planin e prokurimit. Ndër më të rëndësishmet janë angazhimi i përhershëm lidhur me modernizimin e infrastrukturës së IT-së , projekti mbi digjitalizimin e proceseve dhe krijimin e arkivës digjitale brenda ndërmarrjes, asgjësimin e domentacionit të vjetërsuar , skanimin e dokumentacionit në përgjithësi.

**Zyra Ligjore:**

Përveç punëve të zakonshme me të cilat përballet shërbimi, gjatë periudhës tremujore -TM1 - 2025 është zhvilluar procedurë për këto lëndë :

| Nr. | I paditur/debitor | Paditës/kreditor | Kontesti | Rrjedha |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Shaip Svirca | NH "Ibër - Lepenc"Sh.A | Kompenzim Dëmi | Me datën 08.01.2025 në Gjykatën Themelore në Prishtinë është mbajtur seanca fillestare ku paditës është NH "Ibër- Lepenc" Sh.A dhe i paditur është Shaip Svirca nga KK Barilevë.<br>Në këtë seancë, pala e paditur ka kërkuar që të shtyhet seanca duke shprehur gatishmërinë e tij për të arritur një marrëveshje me NH "Ibër-Lepenc" Sh.A. Pala e paditur në këtë seancë ka deklaruar se është i gatshëm të arrijë marrëveshje jashtëgjyqësore dhe të paguaj detyrimin.<br>Me datën 13.01.2025 është arritur marrëveshja dhe pala e paditur ka paguar detyrimin e tij ndaj paditëses N.H "Ibër Lepenc" Sh.A. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | Me datën 14.01.2025 në Gjykatën Themelore në Prishtinë kemi dorëzuar parashtresën për tërheqjen e padisë. |
| 2. | Naim Leci | NH "Ibër - Lepenc"Sh.A | Lirim prone | Me datën 14.01.2025 është mbajtur seanca, në të cilën kemi shprehur qëndrimin tonë lidhur me pronën kontestuese dhe njëkohësisht kemi kundërshtuar kundërpadinë e ushtruar nga i padituri. Në këtë seancë, është kërkuar nga Gjykata që të caktohet eksperti i gjeodezisë dhe të hartojë ekspertizën gjeodezike, duke përshkruar gjendjen reale faktike në terren, si dhe të përcaktohet saktë parcela kontestuese dhe objektet që janë të ndërtuara në të. Pas pranimit të ekspertizës, do të dorëzojmë në gjykatë precizimin e padisë. Seanca e radhës është caktuar për datën 08.04.2025. |
| 3. | NH "Ibër - Lepenc"Sh.A | Kasalovic Goran | Kontest pune - Anulim konkursi | Me datën 14.01.2025 kemi pranuar padinë e ushtruar nga Kasalovic Goran kundër NH "Ibër -Lepenc" Sh.A, lidhur me konkursin publik nr. 02-4189 të datës 05.11.2024. Me padi është kërkuar që të caktohet masa e sigurisë. Seanca është mbajtur më datën 22.01.2025 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë në të cilen jemi informuar nga Gjykata që pala paditëse ka bërë tërheqjen e padisë. Ndërsa me datën 24.01.2025 kemi pranuar aktvendimin me numer 05-231 të datës |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | 24.01.2025 me të cilin është konstatuar se pala është tërhequr nga padia. |
| 4. | Ilmije Qoku | NH "Ibër Lepenc"Sh.A | Lirim prone | Me datën 14.01.2025 kemi pranuar ankesen e ushtruar nga e paditura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, me numër C.nr.988/2019 të datës 27.09.2024. Me datën 17.01.2025 në Gjykatë kemi dorëzuar përgjigje në ankesën e datës 14.01.2025. |
| 5. | Xhemajl Fazlia | NH "Ibër - Lepenc"Sh.A | Lirim prone | Me datën 15.01.2025 në Gjykatën Themelore në Prishtinë është mbajtur seanca, në të cilën ishim të pranishëm si paditës, ndërsa pala e paditur nuk e ka pranuar ftesën dhe nuk ishte e pranishme në këtë seancë. Andaj, gjyqtarja ka konsideruar që nuk ka kushte për mbajtjen e seancës. Ndërsa me 21.02.2025, në Gjykatën Themelore në Prishtinë është mbajtur seanca, ku pala e paditur edhe pas publikimit në tabelen e shpalljeve nga ana e gjykates, prap nuk ka prezantuar në seancë. Gjatë kësaj seance, kemi dorëzuar një shkresë me adresën e të paditurit. Gjykata ka nxjerrë aktvendim për të shtyrë seancën dhe për të dërguar ftesë në adresën e dorëzuar. Seanca e ardhshme do të mbahet më 22.04.2025. |
| 6. | NH "Ibër - Lepenc"Sh.A | Emin Zejnullahu | Vertetim Pronësie | Më datën 16.01.2025, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, dega në Vushtrri, është mbajtur një seancë ku |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | palët kanë shprehur qëndrimet e tyre. Gjatë seancës, të dy palët kanë shprehur pakënaqësi ndaj ekspertizës gjeodezike dhe kanë propozuar që gjykata të kërkojë në Zyrën Kadastrale të Komunës së Vushtrrisë informacionin mbi gjendjen e parcelave kontestuese para komasacionit. Gjykata, me aktvendim, ka aprovuar këtë kërkesë të palëve dhe, pas marrjes së përgjigjes nga Komuna e Vushtrrisë, ndërsa me datën 28.03.2025 nga Gjykata kemi pranuar dokumentet e kërkuara nga Kadastri i K.Vushtrrisë lidhur me komosacionin. |
| 7. | NH "Ibër - Lepenc"Sh.A | Sami Morina | Kompenzim dëmi | Me datën 29.01.2025 lidhur me lënden me numër C.nr. 319/24 kemi pranuar parashtresë nga Gjykata Themelore në Drenas me të cilen jemi njoftuar që pala paditëse ka tërhequr padinë ndaj të paditures së tretë NH "Ibër- Lepenc"Sh.A |
| 8. | NH "Ibër - Lepenc"Sh.A | Ibrahim Shala | Kompenzim Dëmi | Në datën 4 shkurt 2025, në Gjykatën Themelore në Drenas është mbajtur seanca në të cilën palët janë pajtuar që të nënshkruajnë një marrëveshje ndërgjyqësore, dhe e paditura është e obliguar të paguajë shumën e dëmit, duke përfshirë edhe shpenzimet, në mënyrë solidare, në vlerë totale prej 937.50 euro për palën paditëse. Me datën 08.02.2025 është ekzekutuar pagesa sipas |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | Aktvendimit C.nr.30/14 të datës 04.02.2025. |
| 9. | Afrim Sadiku | NH "Ibër - Lepenc"Sh.A | Lirim prone | Më datën 05.02.2025 është mbajtur seanca në terren, në të cilën ishte prezent edhe eksperti gjeodet, i cili pas daljes në terren dhe ekzaminimit të gjendjes reale dhe faktike, ka hartuar ekspertizën gjeodezike. Me datën 21.03.2025, nga Gjykata Themelore në Mitrovicë kemi pranuar ekspertizën gjeodezike të hartuar nga gjeodeti i caktuar nga Gjykata me aktvendim për çështjen me numrin 402/15, ku paditës është NH "Ibër - Lepenc" Sh.A dhe i paditur është Afrim Sadiku, për çështjen kontestimore të lirimit të pronës. Bazuar në ekspertizën gjeodezike, do të përgatisim precizimin e padisë dhe do ta dorëzojmë në gjykatë në seancën e radhës, e cila do të mbahet më datën 23.04.2025. |
| 10. | NH "Ibër - Lepenc"Sh.A | Jelica Celiq, Bllagica Celiq, Simana Celiq, dhe Angjela Celiq | Vertetim Pronesie | Më datën 11.02.2025, nga Gjykata e Apelit në Prishtinë kemi pranuar ankesën kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore me numër C.nr 1208/2012, të datës 22.04.2024.<br>Lidhur me këtë kemi përgatitur përgjigjen në ankesë ku kemi kundërshtuar të gjitha pretendimet e paditësit. |
| 11. | Ismet Shasivari | NH "Ibër - Lepenc"Sh.A | Lirim Prone | Më datën 11.02.2025 kemi pranuar Aktvendimin, me të cilin është konstatuar se |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | procedura për çështjen juridike kontestimore ndërpritet për shkak të vdekjes së të paditurit. Procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur pasardhësit e të paditurit ta marrin përsipër procedurën. |
| 12 | Shefqet dhe Sheremet Aliu | NH "Ibër - Lepenc"Sh.A | Lirim Prone | Më 14.02.2025, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë është mbajtur seanca përfundimtare, në të cilën ka qenë prezent njëri nga të paditurit dhe avokati i të paditurve sipas autorizimit. Në këtë seancë është dëgjuar edhe eksperti gjeodet, si dhe vetë pala në cilësinë e dëshmitarit. Në këtë rast, palët kanë shfrytëzuar mundësinë për të bërë pyetje ndaj gjeodetit dhe palës.<br>Me datën 07.03.2025, kemi pranuar Aktgjykimin me numër 05-739 lidhur me çështjen kontestimore me numër C.nr.404/2015 për lirim prone, me të cilin është aprovuar në tërësi si e bazuar padia e ushtruar nga NH "Ibër -Lepenc" Sh.A, kundër të paditurve Shefqet dhe Sheremet Aliu. |
| 13. | Musa Selmani | NH "Ibër - Lepenc"Sh.A | Lirim Prone | Më datën 18.02.2025 u mbajt seanca në të cilën pala ka munguar, ndërsa në këtë seancë kemi dorëzuar një shkresë për gjykatën. Po presim aktvendimin dhe ftesën për seancën e radhës. |
| 14. | NH "Ibër- Lepenc"Sh | Hamit Osmani | Kompenzim Dëmi | Më datën 06.03.2025, nga Gjykata Themelore në Prishtinë kemi pranuar ekspertizën me numë 05-726, e hartuar nga eksperti gjyqësor |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | i ndërtimtarisë për lëndën me numrin C.nr.2612/23. Po ashtu, kemi pranuar raportin e vlerësimit për fitimin e humbur, me numër 05-727/1, të datës 06.03.2025, të hartuar nga eksperti i bujqësisë. Seanca është mbajtur më datën 25.03.2025 në Gjykatën Themelore në Prishtinë. |
| 15. | NH "Ibër - Lepenc"Sh.A | Future Energy Trading and Exchange Dynamics Sh.P.K, | Shpërblim dëmi për shkak të mos përmbushjes së kontratës | Me datën 10.03.2025, nga Gjykata Komerciale në Prishtinë, kemi pranuar padinë me numrin e lëndës KE.Nr.155/23, e ushtruar nga Future Energy Trading and Exchange Dynamics Sh.P.K, kundër NH "Ibër- Lepenc" Sh.A. Më datën 17.03.2025, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, kemi dorëzuar përgjigjen në padi me numrin 02-842 për çështjen kontestimore lidhur me shpërblimin e dëmit për shkak të mos përmbushjes së kontratës. |
| 16. | NH "Ibër-Lepenc"Sh.A | Albulena Avdija | Kompenzim i diferencës se pages | Me datën 18.03.2025, nga Gjykata Themelore në Prishtinë kemi pranuar padinë me numrin e lëndës C.nr.9043/24, e ushtruar nga paditësja Albulena Avdija, të cilën e përfaqëson avokati Armend Deskaj, për çështjen kontestimore të kompenzimit të diferencës në pagë. Jemi në përgatitje të përgjigjes në padi, të cilën do ta dorëzojmë në gjykatë brenda afatit të caktuar ligjor. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 17. | NH "Ibër - Lepenc"Sh.A | Avni Haliti | Kompenzim Dëmi | Me datën 25.03.2025, kemi pranuar ftesën për seancën e radhës, e cila do të mbahet më datën 17.04.2025 në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Ftesa është dërguar nga gjykata për të njoftuar të gjitha palët e përfshira në çështjen ligjore për zhvillimin e seancës gjyqësore. Ne do të jemi të pranishëm në këtë seancë dhe do të paraqesim të gjithë dokumentacionin dhe provat përkatëse për mbështetje të padisë. |

**Të tjera:**

- Regjistirimi i pagesave për rastet që janë në procedurë përmbarimore sipas raportimit nga financat;
- Përcjellja e raporteve të pagesave të Përmbaruesja Private;
- Përfundimi i (1) një lëndë me urdhër për përmbarim;
- Dorëzimi i shkresave të ndryshme në Gjykatën Themelore dhe Zyre Përmbarimore.

**Zyra për Burime Njerëzore**

- Zyra për Burime Njerëzore në kuadër të muajve Janar-Shkurt-Mars, sipas kërkesave të punëtorëve aktual janë përgatitur vendime për pushim vjetor, pushime mjekësore për punëtorët të cilët kanë sjellë dëshmitë e tyre nga Qendrat mjekësore.

Vazhdimi i procedurave për konkurse të jashtme si në vijim :

- Gjatë TM1 janë filluar procedurat e rekrutimit për të gjitha pozitat e shpallura në konkurset publike gjatë muajit Janar- Shkurt 2025 konkurse këto të përfunduara në muajin Mars:
- Inxhinier i Makinerisë- Shkabaj- (1)
- Inxhinier i Makinerisë- Prishtinë- (1)
- Inxhinier i Ndërtimtarisë- Konstruktiv- (1)
- Inxhinier i Ndërtimtarisë- Hidro- (1)
- Shef i Shërbimit IT-së- (1)
- Punëtor në Njësinë e Mirëmbajtjes së Digave- (1)
- Inxhinier për mirëmbajtjen e sistemit SCADA- (1)

Ndërsa pozitat të cilat janë anuluar pas fazës së parë të testit me shkrim janë:

- Inxhinier i operimit mirëmbajtjes ndërtimore të objekteve hidroteknike në H.S dhe mbrojtja nga ujërat- (1)
- Teknik për mirëmbajtjen elektrike/ Elektromontues- (1)

- Punëtor në mirëmbajtjen e infrastrukturës- (1).

Pra procedurat për rekrutimin e punëtorëve për këto pozita kanë përfunduar me kohë dhe pa asnjë problem .

***Plotësimi i dokumentacionit lidhur me kërkesat e auditorëve***

Gjatë muajit mars BNJ ka përgatitur dokumentacionet dhe dosjet e kërkuara nga auditorët:

- 50 kontrata të punës për 50 punëtorët e ndërmarrjes,
- 9 Kontratat e punës për punëtorët e pa sistematizuar,
- 6 kontratat e punës për punëtorët që kanë ndgritje të pagës sipas vendimit ,
- Vendimet e K.E për ngritjen e pagave për këta punëtor,
- Vendimet e Bordit për ngritjen e pagave për këta punëtor,
- Listën e Pakos për daljen vullnetare nga puna,
- Marrëveshjen për Pako për daljen vullnetare nga puna,
- Vendimin për Pako për dalje vullnetare nga puna,
- Kontratat e Punës për punëtorët për dalje vullnetare nga puna,
- Procesin e rekrutimit (konkursit publik) për pozitën Udhëheqës i Njësisë Punuese në Vushtrri,
- Procesin e rekrutimit (konkursin publik) për pozitën Shef i Shërbimit për planifikim dhe monitorim të projektit,
- Listën e punëtorëve me të dhënat e tyre, pozitën dhe poenat para dhe pas sistematizimit.
- Listën e punëtorëve të rekrutuar gjatë vitit 2024,
- Listën e punëtorëve të rekrutuar në pozitat e lira pas Pakos vullnetare,
- Listën e pensionisteve për vitin 2024,
- Kontratat e punës të pensionistëve të vitit 2024,
- Plani i trajnimeve për vitin 2024.

**Zyra e IT-së:**

- Mirëmbajtja e Firewall.
- Mirëmbajtja e sigurisë se rrjetit.
- Mirëmbajtja e VPN ip sec connection me pikat Shkabaj, Vushtrri Komoran.
- Mirëmbajtja e sigurisë se pajisjeve( PC, Laptop, Printer, Telefon, Server).
- Mirëmbajtja e Email-eve.
- Mirëmbajtja e programit të hyrje daljeve KIT-TAS.
- Krijimi i Share Folderave sipas kërkesave të ndërmarrjes.
- Mirëmbajtja e share folder-ave.
- Ndalimi permes firewall I TOR Proxy per shkaqe sigurie.
- Formatizimi I PC për prokurimin ( Instalimi win 11, konfigurimi I E-mail, instalimi I programeve të nevojshme dhe konfigurimi në printim , skanim ).

Janë përfunduar të gjitha obligimet dhe punët tjera sa i përket pjesëve ditore ligjistike dhe infrastrukturore të cilat kërkohen gjatë aktiviteteve të rregullta të punës dhe nevojave të stafit dhe menxhmentit.

## *Zyra e Prokurimit*

Gjatë tremujorit të parë 2025 (**TM1- 2025**), Departamenti i Prokurimit ka zhvilluar këto aktivitete:

| # | *Nr prok* | *Titulli* | *Data e inicimit* | *Procedura dhe vlera e parashikuar* | *Data e hapjes* | *Nënshkrimkontrate* | *Vlera e kontratës* | *Kompania fituese* | *Komente* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 24-040 | Rivlerësimi i Aseteve në Ndërmarrjen Publike NH "Ibër Lepenc" Sh.a. | 22.08.2024 | E hapur Vlerë e Mesme 100,000.00 € | 17.01.2025 | 10.02.2025 | 89,900.00 € | GOE: Pro Acc Group SH.P.K., H&N SH.P.K., NIKA PrO-Ing SH.P.K. | **Kontraktuar!** |
| 2 | 24-051 | Furnizim me pajisje te IT-se | 08.10.2024 | E hapur Vlerë e Mesme 27,000.00 € | 17.01.2025 | / | / | / | **Anuluar,** pasi qe oferta e vetme e pranuar eshte vleresuar si e papergjegjshme. |
| 3 | 24_054 | Digjitalizimi, vektorizimi, gjeoreferencimi i projekteve te profiit gjatesor te kanalit, hartave te ujitjes dhe largperquesve | 31.10.2024 | E hapur Vlerë e mesme 50,000.00 € | 25.11.2024 | / | / | / | Sipas Vendimit te Panelit te OSHP: 2025/0001 , aktiviteti kthehet ne **Ri-vleresim** |
| 4 | 24_059 | Furnizim me pajisje GPS GNSS dhe pjesët tjera përcjellese - RITENDER | 15.11.2024 | E hapur Vlerë e mesme 27,000.00 € | 13.12.2024 | / | / | / | Është pranuar raporti i Ekspertit të OSHP, por jemi në pritje të Vendimit të Apelit të OSHP. |
| 5 | 24_065 | Furnizim me Vetura me rimorkio për terren (6 copë) | 09.12.2024 | E hapur Vlerë e madhe 360,000.00 € | 20.01.2025 | / | / | / | **Asnjë ofertë e pranuar!** |
| 6 | 24_048 | Penda Ujman dhe Pridvorice - RITENDER | 19.12.2024 | E hapur Vlerë e mesme 60,000.00 € | 10.01.2025 | / | / | / | **Ofertat e pranuara për 2 nga 3 Lotet e shpallura janë të papërshtatshme** |
| 7 | 24_069 | Mirëmbajtje e Licencave NAV, mirëmbajtje dhe zhvillime në | 19.12.2024 | E hapur Vlerë e mesme 23,000.00 € | 08.01.2025 | / | / | / | **Anuluar sepse është pranuar vetëm një** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | sistemin ekzistues ERP-BC 14 | | | | | | | **ofertë e papërgjegjshme, dhe pritet të Ritenderohet!** |
| 8 | 25-001 | Furnizim me material higjienik | 23.01.2025 | Kuotim Cmimi 6,840.00 € | 30.01.2025 | / | / | / | Është pranuar raporti i Ekspertit te OSHP, por jemi në pritje të Vendimit të Apelit të OSHP. |
| 9 | 25-002 | Angazhimi i një zyreje projektuese për studimin e sanimit të rreshqitjeve | 24.01.2025 | E hapur Vlerë e mesme 40,000.00 € | 21.02.2025 | / | / | / | Pas pakënaqësisë dhe ankimimit nga OE oferues që nuk kanr ofruar ofertë të përgjegjshme **Aktiviteti është në ankimim në OSHP!** |
| 10 | 25-003 | Furnizim me IT për UJMAN | 23.01.2025 | Vlere Minimale 995.00 € | 24.01.2025 | 28.01.2025 | 989.59 | "KOSPROD " SH.P.K. | **Kontraktuar!** |
| 11 | 25-004 | 25-004 | Riparimi i motorrit per veturen FORD KUGA | 27.01.2025 | Kuotim Cmimi 2,290.38 € | 07.02.2025 | 21.02.2025 | 2,290.38 € | OE: Ramadan Raci B.I. |
| 12 | 25-005 | Vlerësimi i rrezikshmërisë në punë | 27.01.2025 | E hapur Vlerë e mesme 23,000.00 € | 24.02.2025 | 24.03.2025 | 20,650.00 | OE: "Bli TERM" | **Kontraktuar!** |
| 13 | 25-006 | Mirëmbajtje të Licencave NAV, mirëmbajtje dhe zhvillime në sistemin ekzistues ERP-BC 14 ( RITENDER )" | 04.02.2025 | E hapur Vlerë e Mesme 23,000.00 € | 24.02.2025 | | | | **Në proces!** |
| 14 | 25-006 | Mirëmbajtje të Licencave NAV, mirëmbajtje dhe zhvillime në sistemin ekzistues ERP-BC 14 ( RITENDER )" | 04.02.2025 | E hapur Vlerë e Mesme 23,000.00 € | 24.02.2025 | 13.03.2025 | 22,792.88 | Grup i OE: ASSECO SEE SH.P.K.; Business Solution | **Kontraktuar!** |
| 15 | 25-007 | Sigurimi shëndetësor për personelin e Ibër Lepenc-it | 10.02.2025 | E hapur Vlerë e Madhe 292.623,00 € | 28.03.2025 | | | | **Në proces!** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 16 | 25-008 | Furnizim i një gjeneratori 70 kVa për digën e Ujmanit | 05.02.2025 | E hapur Vlerë e Mesme 11,000.00 € | 25.02.2025 | 13.03.2025 | 6,249.28 | OE: Eor Group SH.P.K. | **Kontraktuar!** |
| 17 | 25-009 | Blerja e licensave per programe profesionale AutoCad | 12.02.2025 | E hapur Vlerë e Mesme 22,000.00 € | 11.03.2025 | | | | **Në proces!** |
| 18 | 25-010 | Furnizim me material teknik për punëtorinë elektrike dhe mekanike në Shkabaj, dhe furnizim me kositëse elektrike për bari për SP dhe ON | 12.02.2025 | Kuotim Cmimi 4,000.00 € | 20.02.2025 | 12.03.2025 | 3,993.30 | OE: : "INFINIT" SH.P.K. | **Kontraktuar!** |
| 19 | 25-011 | Furnizim me lidhëse riparuese dhe vegla pune për UJITJE | 14.02.2025 | E hapur Vlerë e Mesme 30,000.00 € | 14.03.2025 | | | | **Në proces!** |
| 20 | 25-012 | Furnizim me mjete pune për shërbimin e mirëmbajtës së liqenit, digave dhe infrastrukturës | 18.02.2025 | Kuotim Cmimi 9,000.00 € | 25.02.2025 | | | | **Në proces!** |
| 21 | 25-013 | Riparimi i pompave të Drenazhes në SP Besi dhe SP Bivolak, Rehabilitimi i pompave në SP Samadregjë. | 18.02.2025 | E hapur Vlerë e Mesme 11,000.00 € | 10.03.2025 | | | | **Asnje nga 2 ofertat e pranuara nuk ishin oferta të përgjegjshme! Anuluar** per t'u Ritenderuar |
| 22 | 25-014 | Furnizim me fazoneri | 18.02.2025 | E hapur Vlerë e Madhe 150,000.00 € | 07.04.2025 | | | | **Asnje oferte e pranuar! Anuluar** per t'u Ritenderuar |
| 23 | 25-015 | Furnizimi me tepih elektroizolues dhe indikatorë të TL për S.P Besi dhe S.P Bivolak | 20.02.2025 | Kuotim Cmimi 8,000.00 € | 27.02.2025 | | | | **Në proces!** |
| 34 | 25-016 | Rindertimi segmenteve të pjesëve të Kanalit Besi-Graçankë | 20.02.2025 | E hapur Vlerë e Mesme 450.000,00 € | 24.03.2025 | | | | **Në proces!** |
| 25 | 25-018 | Shërbimet e transportit me Autobus | 26.02.2025 | Vlerë Minimale 350,00 € | 27.02.2025 | 28.02.2025 | 278.00 € | OE: NPT "AURELA – TOURS" | **Kontraktuar!** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 26 | 25-019 | Furnizim me material zyrtar | 24.02.2025 | Kuotim Cmimi 6.240,00 € | 05.03.2025 | | | | **Në proces!** |
| 27 | 25-020 | Furnizim me foltore dhe banner me mekanizëm. | 27/02/2025 | Vlerë Minimale 410.00 € | 28.02.2025 | 03.03.2025 | 409.00 | OE: BMS SOLUTIONS L.L.C. | **Kontraktuar!** |
| 28 | 25-021 | Furnizimi dhe ndërrimi i tabelave komanduese në SP Gjurashin dhe SP Krashticë | 03.03.2025 | E hapur Vlerë e Mesme 50,000.00 € | 27.03.2025 | | | | **Në proces!** |
| 29 | 25-023 | Furnizimi i shufrave te Statorit per nevoja te HC Ujmani | 10.03.2025 | Kuotim Cmimi 4,000,00 € | 20.03.2025 | | | | **Asnje oferte e pranuar! Anuluar** per t'u Ritenderuar |
| 30 | 25-025 | Ndërrimi dhe Balancimi i Gomave për Sezonin e Verës dhe Dimrit | 10.03.2025 | Vlerë Minimale 750.00 € | 12.03.2025 | | | | **Asnje oferte e pranuar! Anuluar** per t'u Ritenderuar |
| 31 | 25-024 | Furnizim me pajisje IT-se. | 10.03.2025 | E hapur Vlerë e Mesme 27,000.00 € | 17.04.2025 | | | | **Në proces!** |
| 32 | 25-022 | Blerja e mjeteve specifike të punës për DPZH | 11.03.2025 | Kuotim Cmimi 2,000,00 € | 19.03.2025 | 10.04.2025 | 1,771.00 | OE: JON GROUP L.L.C. | **Kontraktuar!** |
| 33 | 25-017 | Riparimi i fluturakeve, valvulave jo kthyese në SP Besi. | 13.03.2025 | Kuotim cmimi 9,000.00 € | 19.03.2025 | 04.04.2025 | 8,100.00 | EE: ALY GROUP SH.P.K. | **Kontraktuar!** |
| 34 | 25-026 | Furnizimi me Vajra dhe Yndyrna për Ujman, Statcione Pompike dhe Objekte Ndarese | 17.03.2025 | E hapur Vlerë e Mesme 16,000.00 € | 11.04.2025 | | | | **Në proces!** |
| 35 | 25-027 | Furnizim me Vetura me rimorkio për terren (6 copë)-RITENDER | 17.03.2025 | E hapur Vlerë e Madhe 360,000.00 € | 05.05.2025 | | | | **Në proces!** |
| 36 | 25-025 | Ndërrimi dhe Balancimi i Gomave për Sezonin e Verës dhe Dimrit ( RITENDER ) | 19.03.2025 | Vlerë Minimale 750.00 € | 20.03.2025 | | | | **Asnje ofertë e pranuar! Anuluar** per t'u Ritenderuar, sipas nevojave të Ndërmarrjes! |
| 37 | 25-028 | Studimi i fizibilitetit për shfrytëzimin e aseteve të IL-së për | 20.03.2025 | E hapur Vlerë e Mesme | | | | | **Në proces!** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | prodhim të energjisë alternative-Solare | | 60,000.00 € | 23.04.2025 | | | | |
| 38 | 25-023 | Furnizimi i shufrave te Statorit per nevoja te HC Ujmani - RITENDER | 26.03.2025 | Kuotim cmimi 4,000.00 € | 04.04.2025 | | | | **Në proces!** |
| 39 | 25-029 | Rehabilitimi i Gypit J-tranzit, Çelik - Beton | 28.03.2025 | Kuotim cmimi 7,000.00 € | 07.04.2025 | | | | **Në proces!** |
| 40 | 25-031 | Furnizim me pjesë rezervë për nevoja të NJP Ujman | 28.03.2025 | Kuotim çmimi 10,000.00 € | 25.04.2025 | | | | **Në proces!** |

## ***<u>Departamenti Planifikim dhe Zhvillim</u>***

Të bashkangjitura gjeni aktivitetet dhe veprimet punuese nga DPZH përgjatë muajve: Janar, Shkurt dhe Mars 2025. Përgjatë këtij tremujori ka vazhduar aktiviteti punues nga muajt paraprak si dhe ka pasur zhvillime të tjera të cilat janë në kompetencën e drejtorisë.

Në TM1, 2025 janë realizuar këto aktivitete:

**Kemi pranuar nga arkiva këto raporte për muajt Janar, Shkurt dhe Mars 2025, nga menaxherat e kontratave si në vijim:**

- Raporti periodik për kontratën me titull **"Sigurimi shëndetësor për punëtorët e Ibër-lepencit"** me nr prok. IL-22-97-2-1-1 nga menaxherja Dorentina Thaqi, projekti do të përfundoj me datë 06/04/2025.
- Vendimin për hapjen e tenderit **"Blerja e mjeteve specifike të punës për DPZH".**
- Raportin e punës për kontratën me titull **"Furnizim me pije per byfe"** me nr. prot: 08-610 të datës 25.02.2025.
- Raportin periodik për kontratën me titull **"Furnizim me pije per byfe",** me nr. prot: 08-900 të datës 24.03.2025.

**Aktivitetet e tjera gjatë TM1 2025 në kuadër të departamentit tonë kanë qenë:**

- Hartimi i Specifikimeve Teknike për projektin: **"Blerja e Licencave për Programe profesionale", ku** është nënshkruar kontrata më 01.04.2025, dhe me vendim është caktuar menaxheri i kontratës.
- Mbikëqyrja e punimeve në kontratën: **"Sanimi dhe Renovimi i Objekteve Ndarëse dhe Stacioneve Pompike Besi (Besi, Çagllavicë)",** me numër identifikues IL-24-4147-5-2-1-1; Projekti është në zhvillim, drejt finalizimit, se shpejti bëhet pranimi I punimeve nga Komisioni mbikqyrës.

- Kontrollimi i projektit në kontratën me titull: "Riparimi i dy segmenteve me nga L=90.0m të kanalit në Babin Most, njeri me profil tërthor A11 dhe tjetri A12"; Projekti është në zhvillim pra ka filluar tani!
- Identifikimi i projekteve të reja nga kontratat e siguruara nga arkiva për përditësimin e tabelave monitoruese për nevojat e DPZH-së.
- Ri-Vlerësim për projektin: "Vendosja e video kamerave ne NjP, SP dhe ON - për këtë pikë komisioni vlersues ka filluar duke punuar me datën 27.01.2025 deri me datën 31.01.2025.
- Ri-Vlerësim për projektin: "Penda Ujman dhe Pridvoricë s- Ritender" - komisioni vlerësues ka filluar me punë me datën 27.01.2025 deri me datën 31.01.2025.
- Vlerësim i tenderit: furnizimi dhe punët për funksionalizimin e njesisë për mirëmbajtjen e digave, dhe Infrastrukturës në Ujëman – RITENDER, Numri i prokurimit IL-24-13596-5-2-1. Komisioni ka zhvilluar punët me datë 31.01.2025.
- Komision Ri-vlerësimi –Tenderi me titull: "Furnizimi me licenca për Microsoft 365 dhe antivirus për nevojat e N.H- IL". Komisioni ka kryer punën më dt.06.01.2025.
- Analizimi dhe përfundimi i kontratës "Furnizim me material higjienik" me numër identifikuse IL-24-1172-1-3-6.
- Hartimi i Specifikimeve Teknike për aktivitetin e prokurimit: **"Renovimi i Objektit të Drejtorisë".** Specifikimet Teknike janë dorëzuar në kopje fizike më 24.02.2025 sipas Planit të Biznesit 2025 dhe vendimit .
- Hartimi i Specifikimeve Teknike për aktivitetin e prokurimit: **"Blerja e mjeteve specifike të punës për DPZH".**
- Hartimi i Specifikimeve Teknike për projektin: **"Rehabilitimi i objektit - Punëtoria e Autoparkut, Çatia, Depoja, Objekti i Rojës, rregullimi i zyrës së punëtorëve, ndarja e terminalit, zyrës si dhe rregullimi i zyreve të arkivës", për nevojat e Departamentit të Ujitjes.**
- Hartimi i Specifikimeve Teknike për projektin: **"Studimi i fizibilitetit për shfrytëzimin e aseteve të IL-së për prodhim të energjisë alternative-Solare".**
- Matjet në Nj.P. Shkabaj për hartim të specifikave për projektin **"Rehabilitimi i objektit - Punëtoria e Autoparkut, Çatia, Depoja, Objekti i Rojës, rregullimi i zyrës se punëtorëve, ndarja e terminalit, zyrës si dhe rregullimi i zyreve të arkives".**
- Mbikëqyrja e punimeve në projektin "**Sanimi i rrëshqitjes së dheut dhe kanalit kryesor Mihaliq-Besi në Babinmost", me numër identifikus IL-23-967-5-2-1, tek i cili projekt ende nuk është përfunduar aktiviteti punues për shkak se kërkesave për punë shtesë dhe mos realizimi i tyre.**
- Përpunimi i tabelës së projekteve aktuale për raportin mujor. Pranimi i kontratave për projektet e reja nga arkiva për përditësimin e tabelave monitoruese.
- **Punët e komisionit në SCADA projektin** - për këtë pikë komisioni ka vazhduar duke punuar edhe me tutje sipas vendimit të datës 13.06.2019, dhe nr. Protokollit 01-1227/1. Ndërmarrja jonë, tani e sa kohë është në vlugun e implementimeve të projektit të Bankës Botërore, WSCP-G-ICB-2, dhe këto ditë jemi në fazën e përfundimtare të realizimit të projektit SCADA, që po implementohet përmes kompanisë/konzorciumi: "JV Inter-Adria dhe Oskar".

- **Komisioni për evidentimin dhe klasifikimin e dokumentacionit, i cili është jashtë afateve, për ruajtje të mëtutjeshme nga ne si DPZH:** komisioni ka vazhduar duke punuar në bazë të vendimit të datës 23.12.2024, dhe nr. Prot. 02-4779, duke punuar në punët që kanë të bëjnë me ne si DPZH e për Arkivin e DPZH këto ditë kemi përpunuar draft listën e dërguar për përpunim, dhe klasifikim te dokumentacionit. Pothuajse 70% e dokumentacionit është sistemuar deri më tani dhe do jemi gati ne momentin kur do të rinovohen zyret në Drejtori për zhvendosje në ndonjë lokacion tjetër.
- Pjesëmarrja në komisione të ndryshme nga punëtorët e DPZH-së.
- Hartimi i specifikave teknike të projekteve të mbetura sipas Planit të Prokurimit dhe sipas planit të Biznesit 2025 në lidhje me DPZH.
- Përgaditja e raporteve javore/mujore për përformancën e projekteve dhe aktiviteve, duke përfshirë rezultate, sfida dhe rekomandimet për përmirësim.
- Planifikimi i fazave tjera për furnizim në kontratën **"Furnizim me pije për byfe"** me numër identifikus **IL**-24-3334-1-3-6.

## *Njësia zbatuese e projektit WSCP*

Aktivitetet në kuadër Projektit të Bankës Botërore të zhvilluara gjatë tremujorit të parë (TM1) janë pasqyruar si në vazhdim :

| **Projekti me Bankën Botërore** | |
|---|---|
| **RAPORTI TREMUJOR (TM1_2025)** | |
| **Emri i Kontratës:** | **Siguria e Ujit dhe Mbrojtja e Kanalit - WSCP** |
| **Investitori** | **N.H. "Ibër Lepenc" Sh.A Prishtinë** |
| **Nën-projektet** | **1.Rehabilitimi i kanalit kryesor të Ibër Lepencit**<br>**2.Konsulenca**<br>**3.SCADA** |
| | |
| | |
| **1. Emri i Projektit:** | **Rehabilitimi i kanalit kryesor të Ibër Lepencit** |
| **Kontraktori :** | **"Famis.CO and Kit AK Gradnje"** |

| | |
|---|---|
| **Data e firmosjes së kontratës:** | **24/05/2023** |
| **Çmimi i Kontratës:** | **12,875,191.63 €** |
| | |
| **2. Emri i Projektit** | **Konsulenca – Mbikqyrja e punimeve gjatë realizimit të punimeve në kanalin kryesor** |
| **Kontraktori** | **"IPE Proing Sh.P.K"** |
| **Data e firmosjes së kontratës** | **08/06/2019** |
| **Çmimi i Kontratës:** | **270,700.00 €** |
| | |
| **3. Emri i Projektit** | **Furnizimi dhe montimi i sistemit SCADA** |
| **Kontraktori:** | **JV Interadira & OSKAR-EL** |
| **Data e firmosjes së kontratës** | **21/05/2019** |
| **Çmimi i Kontratës:** | **1,072,044.24 €** |
| **Vlera e punimeve të kryera:** | **899,923.20 €** |

**Periudha Raportuese: 01.10.2024 - 31.12.2024**

**Aktivitetet e punës dhe raportimi i tyre**

**Punimet e rehabilitimit dhe riparimit përfshijnë si më poshtë:**

1. Rindërtimi i pjesëve të hapura të të kanalit trapezoid dhe drejtkëndësh me Beton (gjatësia totale përafërsisht 9,194.70 m në gjithsej 55 seksione, në komunat: Zubin Potok, Mitrovicë, Vushtrri, dhe Obiliq), duke ruajtur rrjedhën e panderprerë të Ujit.

2. Zëvendësimi i kanalit të hapur pranë fshatit Zubin Potok me elemente nga betoni dhe mbulesë të kanalit (gjatësia përafërsisht 400 m).

3. Ndërtimi i sektorit të dytë 2 të Rezervuarit Bufer me gjatësi 800 m dhe gjerësi 8m' .

4. Riparimi i Akuadukteve me gjatësi 24600.23m2, riparimi Ii sipërfaqes së brendshme të akuadukteve duke riparuar vrimat dhe aplikimin e materialit hidroizolues si shtresë e sipërme duke përfshirë trajtimin e fugave sipas Specifikimit Teknik dhe kërkesave të furnizuesit.

Numri i akuadukteve është 17 copë me gjatësi totale përafërsisht. 1,989,264.01m në komunat Zubin Potok 7, Mitrovicë 2 dhe Vushtrri 8.

**5. Punime të tjera**

Ndërtimi i murit mbrojtës 318 m'

Pastrimi dhe rivendosja e 41 lëshesave ekzistuese dhe ndërtimi i 10 kanaleve të reja

Ndërtimi i 21 kutive të shpërndarjes së ujit (dhoma betoni nëntokësore direkt në buzë të kanalit me marrjen e ujit nga kanali)

Instalimi i 13 rrjetave metalike në kalimine kanalit nga seksionet e kanalit të hapur në atë nëntokësor.

Punimi i gropave septike (pellgje betoni nëntokësor, 4 x 8,000L), për lidhje me shtëpitë afër kanalit.

**6. Çështjet mjedisore**

Ekzekutimi i punimeve të riparimit dhe rehabilitimit duhet të jetë në përputhje me Kornizën e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (ESIAF), Kornizën e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (ESMF), Kornizën e Politikave të Zhvendosjes (KPZH), politikat dhe procedurat e Bankës Botërore, si dhe legjislacioni.

- Kontraktori "JV Famis Co dhe Kit AK Gradnje" Vazhdimi i punimeve në kanalin kryesor. Pas nënshkrimit të kontratës me datën 24.05.2023, kontraktori "Famis Co dhe Kit AK Gradnje" kanë paraqitur Planin Dinamik të mobilizimit në teren dhe kanë filluar punët sipas kushteve të kontratës FIDIC, ku bazohet projekti "Rehabilitimi i kanalit kryesor të Ibër Lepencit". Gjatë kësaj periudhe të raportimit kontraktori ka punuar me disa pozicione të punimeve:

**Kanali Trapezoidal**

**Kanali Tip A7 (Trapezoidal), Segmenti 2 (Km: 42+266.03 deri në 42+527.60), Gjatësia = 261.57 m**

Kontraktori ka përfunduar me sukses të gjitha punimet për Kanali Tip A7 (Trapezoidal), Segmenti 2 (Km: 42+266.03 deri në 42+527.60). Fusha e punimeve përfshinte:

- Gërmimi i kanalit anësor për devijimin e ujit
- Prishja e strukturave ekzistuese të betonit
- Ndërtimi i shtresës së zhavorrit në nënshtresë
- Vendosja e hekurit për themelin dhe muret e kanalit
- Hedhja e betonit në themel dhe mure
- Aplikimi i hidroizolimit në nyjet e ndërtimit pas betonimit

Është ndërtuar një sistem devijimi i ujit, i cili përfshin dy puseta—një në hyrje dhe një në dalje—të pozicionuara në anën e kanalit ekzistues. Uji është devijuar përmes një bypass-i anësor të hapur.

Bllokimi i rrjedhës së ujit në kanalin ekzistues dhe devijimi i tij nëpërmjet tubave të instaluar është realizuar përmes ndërtimit të dy barierave të përkohshme (stoplog), në përputhje me deklaratën metodologjike të dorëzuar.

**Kanali Tip A4 (Trapezoidal), Segmenti 2 (Km: 29+725.46 deri në 31+190.89), Gjatësia = 1,465.43 m**

Gjatë kësaj periudhe raportimi, Kontraktori ka filluar punimet në Kanali Tip A4 (Trapezoidal), Segmenti 2 (Km: 29+725.46 deri në 31+190.89). Punimet kanë filluar me gërmimin e kanalit anësor për devijimin e ujit. Pasi të përfundojë kjo fazë, do të vijojnë aktivitetet e mëposhtme:

- Demolimi e betonit ekzistues
- Ndërtimi i shtresës së zhavorrit në nënshtresë
- Vendosja e armaturës për themelin dhe muret e kanalit
- Hedhja e betonit në themel dhe mure
- Hidroizolimi në nyjet e ndërtimit pas betonimit

Punimet e betonit për **Stacionin e Parë të Pompimit** në Km: 29+725.46 janë përfunduar. Po ashtu, janë përfunduar edhe instalimet e pompave zhytëse dhe aksesorëve përkatës. Janë instaluar edhe tubat HDPE me diametër 1200 mm për devijimin e ujit në 500 metrat e para. Gjatë muajit **gusht**, janë përfunduar tërësisht punimet e dheut dhe ato të betonit në **Stacionin e Dytë të Pompimit**, në Km: 30+225.46. Në **shtator 2024**, Kontraktori ka dorëzuar propozimin për **Furnizimin me Gjeneratorë** për sistemin e pompave, i cili aktualisht është nën vlerësim nga Inxhinieri.

**Canal type A7 (Trapezoidal), seg.2, (Ch: 42+266.03 to 42+527.60), L=261.57 m'**

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Kontraktori ka vazhduar punimet në Kanalin e tipit **A7 (Trapezoidal),seg.2, (Ch: 42+266.03 deri në 42+527.60)** duke filluar nga gërmimi i kanalit anësor për devijimin e ujit,demolimi i betonit ekzistues, ndërtim shtrese zhavorri nënshtrese, vendosje armature në themel pllakë dhe muret e kanalit, betonimi ne themelin e pllakës dhe murit .

Bypass-i i ujit është i ndërtuar me dy puseta në hyrje dhe dalje në anën e kanalit ekzistues dhe

anashkalimi i ujit përmes anashkalimit të hapur anësor. Bllokimi i rrjedhës së ujit në kanalin ekzistues

dhe devijimi i tij në gypat e instaluar kryhet duke ndërtuar dy ndalesa të përkohshme sipas përshkrimit.

Deri më tani, kontraktori ka përfunduar 1,178.93 metra nga 5,059.89 metra, ose 23.48% të gjatësisë së kanalit trapezoidal. Përveç kësaj, kontraktori ka instaluar bypass-in anësor dhe ka filluar prishjen e 400 metrave të kanalit, duke arritur një progres prej 33.20% në bazë të kostos.

| Nr | Segment No. | from | Up to | Length | Progress |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | A2.1 | Km 16+540.00 | Km 16+864.27 | L= 324.27m | 100.00% |
| 2 | A3.2 | Km 22+340.00 | Km 23+142.70 | L=802.70m | 0.00% |
| 3 | A3.6 | Km 27+138.37 | Km 27+591.20 | L=452.83m | 0.00% |
| 4 | A4.2 | Km 29+725.46 | Km 31+190.89 | L=1,465.43m | 20% |
| 5 | A6.1 | Km 36+147.52 | Km 36+517.89 | L= 370.37m | 0.00% |
| 6 | A6.4 | Km 37+303.78 | Km 37+985.45 | L= 681.67m | 0.00% |
| 7 | A7.2 | Km 42+266.03 | Km 42+527.60 | L=261.57m | 100% |
| 8 | A7.4 | Km 45+704.08 | Km 46+405.13 | L=701.05m | 60.00% 300m' finished Bypass installed for the remaining 400m' |

**Rehabilitimi i Akuadukteve**

Deri në fund të kësaj periudhe raportuese, kontraktori ka përfunduar rehabilitimin e 10

segmentet e Akuadukteve, duke arritur në afërsisht 89.10% të progresit për rehabilitimin e ujësjellësit ose përfundimin 1,897.09 m' nga 2,129,89 m'.

| No | PAK | from | Up to | Length | Progress |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | PAK1.1 | Km 04+305.01 | Km 04+369.35 | L=64.34 m' | 100.00% |
| 2 | PAK1.2 | Km 05+054.00 | Km 05+126.55 | L=72.55 m' | 100.00% |
| 3 | PAK1.3 | Km 07+529.57 | Km 07+586.89 | L=57.32 m' | 100.00% |
| 4 | PAK1.4 | Km 08+542.73 | Km 08+620.00 | L=77.27 m' | 100.00% |
| 5 | PAK1.5 | Km 09+170.86 | Km 09+344.39 | L=173.53 m' | 100.00% |
| 6 | PAK1.6 | Km 09+738.08 | Km 09+817.92 | L=79.84 m' | 0.00% |
| 7 | PAK1.7 | Km 11+078.87 | Km 11+114.64 | L=35.77 m' | 0.00% |
| 7 | PAK1.8 | Km 12+497.55 | Km 12+497.55 | L=162.45 m' | 100.00% |
| 8 | PAK2.1 | Km 19+632.40 | Km 19+799.26 | L=166.86 m' | 100.00% |
| 9 | PAK2.2 | Km 20+085.68 | Km 20+417.58 | L=331.90 m' | 100.00% |
| 10 | PAK2.3 | Km 23+894.68 | Km 24+033.93 | L=139.25 m' | 100.00% |
| 11 | PAK2.4 | Km 24+894.78 | Km 25+080.39 | L=185.61 m' | 100.00% |
| 12 | PAK2.5 | Km 26+111.90 | Km 26+188.67 | L=76.77 m' | 100.00% |
| 13 | PAK2.6 | Km 27+011.97 | Km 27+138.37 | L=126.40 m' | 100.00% |
| 14 | PAK3.3 | Km 34+934.73 | Km 34+975.15 | L=40.42 m' | 0.00% |
| 15 | PAK3.5 | Km 36+517.87 | Km 36+631.37 | L=113.50 m' | 100.00% |
| 16 | PAK4.1 | Km 42+635.09 | Km 42+760.74 | L=125.65 m' | 100.00% |
| 17 | E2A.1 | Km 45+603.62 | Km 45+704.08 | L=100.46 m' | 100.00% |
| | | | Total: | L=2,129.89 m' | 92.67% |

**Kanalet drejtkëndëshe**

Më datë 18 shkurt 2024, Kontraktori ka filluar ndërtimin e bypass-it, nëpërmjet kanalit anësor, në Segmentin B10A.15 nga Km 47+280.00 deri në Km 47+364.47, dhe ka vazhduar me segmente të tjera për kanalin me seksion drejtkëndësh. Deri në fund të periudhës raportuese, kontraktori ka përfunduar afërsisht 90% të seksioneve të kanalit drejtkëndësh.

Në fund të korrikut 2024, Kontraktori ka filluar ndërtimin e bypass-it nëpërmjet kanalit anësor në Segmentin B10A.20 nga Km 48+854.91 deri në Km 49+191.00, me gjatësi L = 336.09m, dhe ka filluar punimet e prishjes dhe gërmimit. Deri në fund të nëntorit 2024, Kontraktori ka përfunduar rreth 84.00% të punimeve. Për më tepër, gjatë muajit nëntor 2024, Kontraktori ka filluar punimet në Segmentin B10A.15 nga Km 47+280.00 deri në Km 47+364.47 me gjatësi L = 84.47m, dhe ka përfunduar rreth 50% të tij.

Zbatimi i bypass-it të ujit nëpërmjet kanalit anësor është një nga masat e ndërmarra nga Kontraktori për të zbutur vonesat. Me këtë lloj bypass-i parashikohet të realizohen të paktën L = 1,032.30m të kanalit të tipit drejtkëndësh.

| Nr | Segment No. | from | Up to | Length | Progress |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | B10A.15 | Km 47+280.00 | Km 47+364.47 | L=84.47m | 100% |
| 2 | B10A.16 | Km 47+551.50 | Km 47+620.00 | L=68.50m | 100% |
| 3 | B10A.17 | Km 47+738.54 | Km 47+869.05 | L=130.51m | 100% |
| 4 | B10A.18 | Km 48+113.12 | Km 48+378.81 | L=265.69m | 100% |
| 5 | B10A.19 | Km 48+428.80 | Km 48+496.00 | L=67.20m | 100% |

| Nr | Segment No. | from | Up to | Length | Progress |
|---|---|---|---|---|---|
| 6 | B10A.19' | Km 48+604.75 | Km 48+684.59 | L=79.84m | 100% |
| 7 | B10A.20 | Km 48+854.91 | Km 49+191.00 | L=336.09m | 90.00% |
| | | | Total: | 1,032.30 | 96.31% |

Up to date Contractor has finished 998.69m' of 1,032.30m' or 96.31%

**Rehabilitimi i kanalit në përqindje (%)**

| Bill No. A2 - Canal Rehabilitation | length | segments | Progress | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | m' | pcs. | length | | number | | percentage |
| Canal section for trapezoidal canal type | 5,067.28 | 8 | **1,178.93** | **m** | **2.80** | **pcs** | **23.48%** |
| Canal section for rectangular open type | 1,032.30 | 7 | **998.69** | **m** | **6.90** | **pcs** | **96.74%** |
| Canal section rectangular closed | 405.38 | 1 | **0.00** | **m** | **0.00** | **pcs** | **0.00%** |
| Rehabilitation of Aqueduct | 2,129.89 | 17 | **1,973.86** | **m** | **15.00** | **pcs** | **92.67%** |

Më 12 Shkurt 2024 ka filluar furnizimi me Tuba HDPE dhe deri në fund të këtij periudha e raportimit të gjitha DN 1200mm, PN 6 dhe DN 900mm, PN 6 janë dorëzuar në kantier Kontraktori ka dorëzuar në kantier pompat për devijimin e furnizimit me ujë, me datë 19 korrik 2024.

Gjatë muajit gusht 2024, kontraktori ka instaluar dy stacione pompimi për 3 pompa secila, dhe ka instaluar pompat duke përfshirë gypat HDPE Ø1200mm, në Segmenti A4.2 nga Km 29+725.46 deri në Km 31+190.89, L= 1,465.43m', duke pasur gati dy anashkalimet e ujit me pompa.

Më poshtë janë dy diagrame që paraqesin përqindjen e përparimit të punimeve duke përfshirë përqindja e punimeve të certifikuara (të paguara), bazuar në çmimin dhe artikujt e BoQ.




| | Works Contract Rehabilitation Works for Iber Lepenc Canal (WSCP-W-ICB-1) | Bill No. 1 - Earth works and clearing; | Bill No. 2 - Canal Rehabilitation; | Bill No. 3 - Water Bypassing; | Bill No. 4 - Buffer Reservoir; | Bill No. 5 - Concrete Works and Utilities; |
|---|---|---|---|---|---|---|
| CUMULATIVE CONTRACT | 100% | 0.36% | 57.15% | 19.01% | 16.13% | 4.50% |
| CONSTRUCTION PROGRESS | 68.75% | 0.34% | 37.16% | 11.15% | 16.13% | 2.01% |
| CERTIFIED PROGRESS | 66.14% | 0.34% | 34.62% | 11.15% | 15.19% | 2.01% |

**Ecuria e punimeve në krahasim me kontratën kumulative.**




**Më poshtë janë paraqitur disa foto të punimeve në terren:**









**Kanal drejtkëndësh i perfunduar dhe rregullimi i hapsirës**





 

**Finalizimi i punimeve të stacionet e pompimit**

- Konsulenca – IPE Proing

Mbikqyrja e punimeve gjatë realizimit të punimeve në kanalin kryesor

Pas nënshkrimit të kontratës me datën 08.06.2022, kompania mbikqyrëse IPE Proing, ka filluar me zbatimin e kontratës, duke angazhaur stafin në teren pasi që kontraktori ka filluar punimet dhe bashkarisht kemi filluar me takimet e rregullta javore, si dhe procedurat tjera të parapara me kontratë.

**Ndërlidhja në terren:**

Gjatë kësaj periudhe kohore ka pasur vizita të shpeshta në terren, vizita këto që janë bërë me qëllim të përcjelljës së punimeve në kanal.

1. **Furnizimi dhe montimi i sistemit SCADA**

**Përshkrimi i Përgjithshëm i punëve të përfunduara nga sistemi SCADA**

- **Studimet e Dizajnit dhe Ekzekutimit**
- **Furnizimet**
- **Rinovimi i Portave**
- **Prodimi I kabinetit elektrik SCADA**
- **Instrumentalizimi**
- **Qendra Globale e Kontrollit**
- **Përfundimi dhe Dorëzimi Formal (në ILC) i Sistemit SCADA si e integruar tërësisht**
- **Dokumente/vizatime të ndërtuara (siç kërkohet për Sistemin e pranuar përfundimisht SCADA)**

Për projektin e SCADA-s, deri më tani është bërë instalimi i kabineteve, censorë dhe pajisjet e tjera, lidhja e sinjaleve dhe me serverin SCADA ka përfunduar, në të gjitha pikat e mëposhtme:

- DO1 – Verbnice, duke përfshirë instalimin e kabinetit të ri elektrik.

- DO2 – Mihaliq, duke përfshirë instalimin e kabinetit të ri elektrik.

- DO3 – Hamidi, duke përfshirë instalimin e kabinetit të ri elektrik.

- DO4 – Drenicë, duke përfshirë instalimin e kabinetit të ri elektrik dhe lyerjen e portave si pjesë e punimet e rinovimit.

- MSHP Besi, duke përfshirë ndërtimin e pusetave të reja (pasi puseta ekzistuese nuk i përshtatej kërkesat për instalimin e matësit të rrjedhës) dhe instalimin e matësit të rrjedhës.

- MSHP Bivolak, duke përfshirë ndërtimin e pusetave të reja dhe instalimin e matësit.

- PSI 1 – Cagllavice, duke përfshirë instalimin e matësit të rrjedhës në pusetën ekzistuese.

- PSI 2 – Samadrexhë,

- PSI 4 - Pantinë,

- PSI 7 – Fushticë,

- PSI 8 – Gjurashin,

- PSI 9 – Korroticë,

- PSI 10 – Krashticë,

- TC "Kosova A", duke përfshirë ndërtimin e pusetave dhe instalimin e matësit dhe valvulës dhe kabineti SCADA i jashtëm me mbrojtje rrethojash.

- Ferronikel, duke përfshirë ndërtimin e pusetave dhe instalimin e matësit dhe valvulës.

- KRU Mitrovica, duke përfshirë ndërtimin e pusetave dhe instalimin e matësit dhe valvulës dhe kabineti SCADA i jashtëm me mbrojtje rrethojash.

- KRU Mitrovicë-Vushtrri, duke përfshirë ndërtimin e pusetave dhe instalimin e matësit të rrjedhës dhe valvule dhe kabinet SCADA te jashtem me mbrojtje rrethoje.

- KRU Prishtina, duke përfshirë instalimin e matësit të rrjedhës, kabinetin SCADA dhe kyçjen në matësit e rrjedhës.

- TC "Kosova B", në këtë lokacion është paraparë të vendoset matësi i rrjedhës dhe valvula në tubacionet në pusetat e sapondërtuara por gjendja ekzistuese në këtë lokacion është se është kanal i hapur, ne - TC "Kosova B", në këtë lokacion është paraparë të vendoset fluorometri dhe valvula në gypa në pusetat e sapo ndertuara por situata ekzistuese ne ketë kantier është se është kanal i hapur.

Punimet programuese të konfigurimit të RTU dhe ngarkimi i grafikëve në HMI kanë përfunduar në të gjitha faqet e implementuara, për faqet e mbetura imitimet e serverit SCADA dhe grafika HMI janë gati dhe zbatohet dhe do të lidhet sapo të instalohen pajisjet në këto vende. Cilësia dhe mbulimi i rrjetit të operatorëve celularë, ndërkohë që Ibër Lepenci ka zgjidhur problemin me rrjetin e shpërndarjës të internetit me fibra optik për instalimin në të gjitha lokacionet siç është parashikuar.